



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.5436/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Drita Rexhaj, kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.A, nga fshati ... – Komuna e Podujevës, kundër të paditurës G..., shpk, me seli në ..., Komuna e Podujevës, me përfaqësues ligjor B.M dhe G.O, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.882/08, i datës 08.11.2018, në seancën jo publike të mbajtur me datë 16.02.2021, mori këtë:

AKT GJYKIM

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës G..., sh.p.k, me seli në ..., Komuna e Podujevës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.882/08, i datës 08.11.2018, VËRTETOHET.

Arsyetim

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.882/08, i datës 08.11.2018, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit B.A, nga fshati ..., Komuna e Podujevës, si të bazuar. Në pikën II ka detyruar të paditurën Ndërmarrja G..., shpk, me seli në ..., Komuna e Podujevës, që në emër të dëmshtëpërlimit t'i paguajë paditësit 12 (dymbëdhjetë) paga mujore në shumë prej 350 euro bruto, në muaj dhe atë sipas kontratës së punës e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse apo në shumë të përgjithshme prej 4.050.00 euro (katër mijë e pesëdhjetë euro), në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të aktgjyqimit, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm. Ndërsa në pikën III ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të aprovohet ankesa e të paditurës në tërësi si e bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i atakuar me refuzimin e tërësishëm të kërkesë padisë si të pa bazuar ose çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B.A, me datë 24.12.2008, pranë Gjykatës së shkallës së parë, ka ushtruar padi ndaj të paditurës G..., sh.p.k, me seli në ..., Komuna e Podujevës, me drejtor G.O, për shkak të mos pagesës së pagave, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësit ti paguaj pagat të cilat ka mbetur pa i paguar në shumën prej 4500 euro, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 4% prej datës 31.07.2007, nën kërcenim të përbarimit me dhunë, në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.882/08, i datës 08.11.2018, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin, gjykata ka theksuar se nuk është kontestuese se palët ndërgjyqëse kanë pasur kontratë pune, e cila është quajtur Kontratë mbi themelimin e marrëdhënies së punës në mes "G&B Tampon" sh.p.k dhe Ixh.dip B.A, ku në pikën II të kësaj kontrate në mënyrë decisive thuhet se "Marrëdhënia e punës do të jetë me afat 1 vjeçar duke filluar nga 1 Qershori 2006 e deri me 31.07.2007". Kontestuese ishte mos pagesa e pagave nga ana e të paditurës për këtu paditësin. Gjykata duke u bazuar në Kontratën e punës e lidhur mes palëve ndërgjyqëse, referencës së lëshuar me nr. 25/9/2007 e datës 25.09.2007, nenit 55 par 2 të Ligjit të Punës dhe nenit 16 lidhur me nenin 262 të Ligjit mbi Marrëdhënien e Detyrimeve, vendosi ta aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë, më hollësisht sikur në dispozitiv të aktgjykimin. Për lartësinë e kërkesëpadisë vendosi sipas kontratës së lidhur mes palëve, ndërsa shuma prej 400 euro nuk iu aprovua, pasi që nga deklaratimet e palëve u vërtetua që shuma prej 400 euro i është dhënë paditësit nga e paditura. Për kamatën vendosi konform nenit 277 të LMD së (Ligji nr.3/3/1978) ndërsa për shpenzime sipas nenit 450 par 1 të LPK –së, pasi që paditësi i ka kërkuar në padi mirëpo nuk i ka specifikuar ato gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimin është i kuptueshëm, rrjedhimisht edhe i përshtatshëm për përbarim, pasi që e drejta e paditësit dhe detyrimi i të paditurës është i përcaktuar mjaftë qartë. Gjykata ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestuese duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që gjykata të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike për shkak se nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar të gjitha faktet thelbësore mbi bazën e të cilave ka vendosur për themeluesin e kërkesëpadsisë. Gjykata në mënyrë të provuar e ka konstatuar ekzistimin e kontratës, kohëzgjatjen dhe lartësinë e saj. Rrethanat faktike përcaktuese për themelësinë e kërkesëpadsisë gjykata i ka provuar me provat e administruara, në këtë rast kohëzgjatjen e raportit kontraktuese në mes të palëve ndërgjyqëse e ka provuar me kontratën e administruar si provë, lartësinë e pagës mujore sipas të njëjtës, referencën e datës 25.09.2007, deklaratimet e palëve në seancë, prandaj gjykata ankimore e pranon në tërësi konstatimin që ka bërë gjykata e shkallës së parë, përkritazi me gjendjen faktike në këtë çështje kontestuese. Gjykata ankimore vlerëson se sipas gjendjes faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Vendimi i atakuar është në harmoni me të drejtën materiale, në këtë rast me referencë në dispozitat nga 148 paragrafi 1 të LMD-së (i vitit 1978) përcaktohet se :” *Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese*”, dhe neni 262 paragrafi 1 parashihet se :”*Kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij*”.

Përveç dispozitave të cituara nga të cilat rrjedhë efekti i kontratës dhe e drejta e debitorit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit, vendimi i atakuar është në harmoni të plotë me dispozitën e cituar nga gjykata e shkallës së parë, me referencë në nenin 55 par 2 të Ligjit të Punës i cili përcakton se “ *Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës*”.

Për gjykatën ankimore nuk qëndrojnë pretendimet ankimore lidhur me at se paditësi nuk e ka përmbushur obligimin e tij të dal nga kontrata dhe se i njëjti nuk ka punuar, për faktin se në referencën për punëtorin B.A e lëshuar nga vet e paditura e datës 25.09.2007, pra pas periudhës së kontratës, ndër të tjera theksohet se “ *i lartcekuri punët i ka kryer çdo herë me kohë dhe me cilësi*”. Shtrohet pyetja sikur i njëjti të mos i kryente punët ose të mos punoj fare sikur që janë pretendimet ankimore, çfarë e ka shtyrë të paditurën ta lëshonte referencën e lartcekur? Nga ku rezulton që pretendimet ankimore si të tilla janë vetëm deklarative, pa mbështetje në shkresa të lëndës dhe pa ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridiko – kontestuese. Sipas gjykatës ankimore, nuk është e mjaftueshme, që qoftë nga njëra apo pala tjetër, të bëhen vërejtje ose deklarime të caktuara lidhur me një fakt apo një provë, aq më tepër në fazën ankimore, por çdoherë palët në procedurë kanë për detyrim të jenë aktive dhe të propozojnë prova konkrete për të vërtetuar pretendimet me të cilat i mbështesin kërkesat e tyre apo të vërtetojnë të kundërtën e një fakti i cili mund të kundërshtohet nga ana e tyre. Me dispozitën e nenit 7.1 të LPK shprehimisht parashihet “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre dhe të propozojnë prova më të cilat konstatohen faktet e tilla*”. Me dispozitën e nenit 319.1, të të njëjtit ligj shprehimisht parashihet “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”. Ndërsa me dispozitën ligjore të nenit 322.3 të LPK-së, shprehimisht përcaktohet „ *Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, Nëse ligji nuk parasheh diç tjetër*”.

Me vet faktin se pala e paditura shprehimisht nuk i ka shkëputur kontratën paditësit, si dhe ndaj tij nuk ka shqiptuar ndonjë vërejtje për mos përmbushjen e detyrave sipas kontratës,

(ose së paku nuk ja ka argumentuar gjykatës këtë me prova përkatëse) me të cilat eventualisht i ka shkaktuar ndonjë dëm palës së paditur, atëherë rrjedhimisht paditësit i takon e drejta për kompensimin e pagave për muajt kontestues.

Për lartësinë e kërkesëpadisë me të drejtë gjykata ka vendosur duke ju referuar Kontratës së Punës, e lidhur mes ndërgjyqësve, pasi që e paditura nuk ka provuar në asnjë mënyrë se ka përmbushur detyrimin ndaj paditësit, në periudhën për të cilën është vendosur në aktgjykim, përveç shumës prej 400 euro, e cila nuk ishte kontestuese mes palëve, andaj edhe pretendimet ankimore në këtë drejtim, Gjykata e Apelit, nuk i ka pranuar si të themelta.

Gjykata e shkallës së parë drejtë del te këtë vendosur edhe lidhur me kamatën ligjore, pasi që kamata është gjykuar në përputhje të plotë me dispozitën ligjore të nenit 277 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Gazeta Zyrtare e ish RSFJ e vitit 1978, i cili ka qenë në zbatim në kohën kur është krijuar raporti detyrimorë mes palëve ndërgjyqëse.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 449 dhe 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5436/18, me datë 16.02.2021

Kryetare e kolegjit
Drita Rexhaj,